



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Arsimit e Shkencës e Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Zyra e Sekretarit të përhershëm/Kancelarija Stalnog Sekretar/Office of the Permanent Secretary

REFERENCË:	2-970
DATA:	20.03.2020
PËR/ZA/TO:	Shtëpitë botuese
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Agim Bërdyna, u.d. sekretar i përgjithshëm MASHTI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për shtyrje të afatit për dorëzimin e dorëshkrimeve për tekste shkollore



Të nderuar,

Me rastin e përhapjes së rasteve të infektimit me virusin COVID – 19, vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës (nr. 01/09, date 13 mars 2020) për shpalljen e masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë, dhe në kontekstin e shpalljes së rrethanave të pandemisë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), janë krijuar rrethana të vështirësuara të funksionimit të institucioneve publike e private në Kosovë.

Në këtë situatë, në bazë të Nenit 5 të Ligjit Nr. 02/L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik, MASHTI, përmes kësaj shkrese, njofton palët e interesuara se afati për dorëzim të dorëshkrimeve i paraparë për 27 mars 2020, shtyhet për tri javë dhe përfundon më 17 prill 2020 kur edhe duhet të dorëzohen të gjitha dorëshkrimet në MASHTI në përputhje me konditat e Konkursit të sipërpërmendur.

Me respekt.